Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/100
Datë 04.03.2020

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2020 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Akreditohet Instituti Profesional "ATC Sh.P.K" me adresë, Rr. "Bedri Pejani" Prishtinë, , për periudhën dy vjeçare 25.02.2020 deri 24.02.2022 për të ofruar vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime të validuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve:

   1.1. Instalues elektrik, Niveli III sipas KKK me 27 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 8 kandidatë.
   1.2. Instalues i ujësjellësit, Niveli III sipas KKK me 26 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 8 kandidatë.
   1.3. Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, Niveli III sipas KKK me 30 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 15 kandidatë.
   1.4. Gjuhë angleze; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 15 kandidatë.

2. Akreditohet Instituti Profesional ATC Sh.P.K me adresë, Rr. "Bedri Pejani" Prishtinë, për periudhën tri vjeçare 25.02.2020 deri 24.02.2023 për të ofruar vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime të validuara:

2.1. Bërës ëmbëlsirash, Niveli III sipas KKK me 30 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 12 kandidatë.

2.2. Ndihmës kuzhinier, Niveli III sipas KKK me 13 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 12 kandidatë.

2.3. Picier, Niveli III sipas KKK me 32 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 12 kandidatë.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për akreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi. Numri i kandidatëve i lejuar për grup është bazuar në hapësirën fizike, pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Institutit Profesional ATC Sh.P.K;
- AKK

Kryetarja e KD të AKK-së
Violeta Dema